



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 1 pika 1.15 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 30 paragrafi 1 të Rregullores mbi Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 165-të, të mbajtur me 28 tetor 2016, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Udhëzimi Administrativ Nr.04/2016 për Rregullimin e Procedurës së Rekrutimit për Punësime me Kontrata të quajtura " Marrëveshje me Shërbime të Veçanta".
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Nenad Lazic
Zv. Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së
- Të gjitha gjykatave të Gjyqësorit të Kosovës
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
	KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Br.No.	01 / 350	
DATA DT.	06-11-2016	
	BOGUTINË - A	

Në mbështetje të nenit 4 dhe 27 të Ligjit nr. 03 /L – 223 Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 paragrafi 4 Ligjit nr.03/1 – 149 Për Shërbimin Civil dhe nenit 29 pika 2 e Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nxjerr:

UDHËZIMI ADMINISTRATIV (04/2016) PËR RREGULLIMIN E PROCEDURËS SË REKRUTIMIT PËR PUNSIMET ME KONTRATA TË QUAJTURA ‘ MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA ’TË CILAT I NËNSHTROHEN LIGJIT PËR DETYRIME

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është që të rregullojë procedurën dhe kriteret unike për punësimet me kontrata të quajtura “ Marrëveshje për shërbime të veçanta “ në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe gjykatave të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrime.
2. Ky udhëzim përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat unike të rekrutimit të kësaj kategorie.
3. Dispozitat e këtij Udhëzimi zbatohen për të gjitha procedurat për punësimet me kontrata të quajtura “ Marrëveshje për shërbime të veçanta “ në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykata.

Neni 2 Përkufizimet

Për qëllime të kësaj rregullore shprehjet e mëposhtme do të kenë këtë përkufizim:

1.1. I **punësuari** - personi fizik i punësuar për të kryer punë ose shërbime me pagesë për punëdhënësin;

1.2. **“Marrëveshje për Shërbime të veçanta”** - nënkupton kontratën e lidhur në mes të Sekretariatit ose gjykatave si punëdhënëses, në njëërën anë dhe punësuarit në anën tjetër.

KAPITULLI I

PROCEDURA E REKRUTIMIT

Neni 3

Rrethanat dhe kategoritë për lidhjen e marrëveshjes për shërbime te veçanta

1. Angazhimet me afat të caktuar për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj kanë të drejtë të i bëjnë gjykatat dhe njësitë e këshillit kur nuk mund të plotësohen pozitat e lira në afat të shkurtër dhe kur kërkohet kryerja e ndonjë pune të përkohshme apo të veçantë , e që nuk plotësohet me pozitë të përhershme.
2. Pozitat të nivelit profesional, administrativo - teknik dhe mbështetës dhe mirëmbajtës nuk mund të plotësohen me marrëveshje për shërbime të veçanta përveç në rrethanave të jashtëzakonshme dhe te pa parashikueshme.
3. Pozitat e nivelit drejtues në as një rrethanë nuk mund të plotësohen me marrëveshje për shërbime te veçanta.

Neni 4

Përcaktimi i kushteve për tu plotësuar një pozitë me marrëveshje për shërbime te veçanta

1. Kushtet që duhet përmbushur për tu iniciuar procedura për lidhjen e marrëveshjes për shërbime te veçanta janë por nuk kufizohet në:

- 1.1. Mungesa e resurseve aktuale për të plotësuar pozitën për të cilën kërkohet lidhje a marrëveshjes
- 1.2. Adresimi i ndonjë rrethane të natyrës urgjente
- 1.3. Kryerja e ndonjë pune specifike
- 1.4. Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar me një kërkesë të arsyetuar nga shefi i njësisë
- 1.5. Arsyetim i shkurtër se pse nuk mund të kryhen ato punë dhe detyra të punës nga stafi aktual i nëpunësve civil,
- 1.6. Nëse është e lirë pse ajo nuk plotësohet përmes procedurës së konkursit,
- 1.7. Vështirësitë që paraqiten në punë nëse nuk mbulohet me kontratë pune.
- 1.8. Për sa kohë nevojitet kjo pozitë.
- 1.9. Puna që kryhet me këto kontrata a ka karakter të përhershëm apo të përkohshëm

Neni 5

Parashtrimi dhe shqyrtimi i kërkesës

1. Kërkesën për plotësimin e pozitës me marrëveshje për shërbime të veçanta mund ta parashtrojë eprori i njësisë ku paraqitet nevoja për plotësim të pozitës.
2. Parashtruesi i kërkesës duhet paraqes kualifikimet që duhet poseduar kandidati për tu plotësuar pozita me marrëveshje për shërbime të veçanta.
3. Kërkesa duhet të përmbajë arsyeshmërinë për plotësimin e pozitës me marrëveshje me shërbime të veçanta, duke përfshirë informacion se:
 - 3.1. për çfarë arsye pozita nuk mund të plotësohet përmes procedurës së rregullt të rekrutimit, apo ato detyra nuk mund të kryhen nga stafi aktual;
 - 3.2. për çfarë arsye detyrat nuk mund të kryhen nga stafi aktual i nëpunësve civil;
 - 3.3. cilat janë vështirësitë që do paraqiten në rast të mos aprovimit të kërkesës, dhe
 - 3.4. periudha kohore për lejimin e marrëveshjes
 - 3.5. pozita për të cilën kërkohet marrëveshja, a ka karakter të përhershëm apo të përkohshëm
4. Kërkesa i dorëzohet për aprovim udhëheqësit më të lartë administrativ apo të autorizuarit të tij. Në rast të aprovimit, zyrtari i personelit inicion pa vonesë zhvillimin e procedurës.

Neni 6
Publikimi i pozitës

Shpallja e pozitës bëhet nga zyrtari i personelit në tabelën e shpalljeve të gjykatave, përkatësisht të Sekretariatit si dhe në ueb faqen zyrtare. Shpallja qëndron e hapur tri (3) ditë pune.

Neni 7
Komisioni dhe procedura e përzgjedhjes së kandidatit

1. Komisioni në përbërje prej tre (3) anëtareve emërohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ apo i autorizuari i tij.
2. Komisioni pas shqyrtimit të të gjitha aplikacioneve, bën listën e ngushtë prej jo më shumë se 5 kandidatëve, duke i ranguar sipas kualifikimit, përvojës së punës, shkathtësive dhe aftësive tjera dhe i fton në intervistë me gojë.
3. Komisioni propozon kandidatin më të mirë udhëheqësit administrativ i më pastaj lejon nënshkrimin e marrëveshjes me shërbime të veçanta.
4. Marrëveshja për shërbime të veçanta fillon së zbatuari pas nënshkrimit nga ana e të punësuarit dhe udhëheqësit më të lartë administrativ.

Neni 8
Angazhimi jo vijues

Marrëveshja për shërbime të veçantë lejohet vetëm në periudhë jo vijuese dhe atë jo më shumë se njëherë brenda vitit kalendarik në rast se kohëzgjatja e marrëveshjes është 6 muaj. Në rast të kundërt, i punësuarit mund të angazhohet edhe më shumë se një herë brenda vitit kalendarik, derisa të përmbushet kontrata maksimale prej 6 muaj.

Neni 9
Mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve

I gjithë dokumentacioni nga këto procedura mbahet dhe ruhet nga zyrtari i personelit.

KAPITULLI II

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Neni 10

Dispozitat kalimtare

Të gjitha kontratat e punës të cilat janë nënshkruar dhe janë valide edhe pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të vazhdojnë së zbatuari deri në skadimin e tyre.

Neni 11

Zbatimi i këtij udhëzimi

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës obligon Sekretariatit e KGJK-së dhe gjykatat që të zbatojnë këtë udhëzim.
2. Sekretariati i KGJK-së i raporton Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare.

Prishtinë, më _____



Këshilli Gjyqësor i Kosovës